



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 3660/1 Prot

Tiranë, më 16.12.2024

V E N D I M

Nr. 46, datë 16.12.2024

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, SIPAS KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRFITOJNË BURSË FINANCIARE PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 (faza e parë)”

Bordi i Administrimit, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, ndryshuar me VKM Nr.784, datë 26.12.2018 dhe VKM Nr. 39, datë 23.01.2019, si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr.3660 Prot., datë 16.12.2024, në mbledhjen e tij të datës 16.12.2024,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve, sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përfitojnë bursë financiare për vitin akademik 2024 - 2025 (faza e parë) (sipas tabelës bashkëlidhur).
 2. Efektet financiare të këtij vendimi (për 228 studentë që plotësojnë kriterin) janë në vlerën 20,520,000 (njëzetëmilion e pesëqind e njëzetëmijë) lekë.
 3. Pagesa për çdo student të kryhet pasi të ketë ardhur konfirmimi nga institucionet përkatëse.
 4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UBT-së.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta DOLLANI

Kryetar

Donika KËRÇINI

Anëtar

Albert KOPALI

Anëtar

Sokol DURO

Anëtar

Blerina DUKA

Anëtar

Florian NURÇE

Anëtar

Altin PRENGA

Anëtar

Konceptoi: N. Ndoci

